



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROÇESVERBAL**

**Nr. 5, datë 23.03.2022**

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin Mars, që zhvillohet me mjete të komunikimit elektronik (aplikacioni SKYPE).**

Orari i fillimit të mbledhjes : 10:04

Data e mbajtjes së mbledhjes : 23.03.2022

Mbajtja e mbledhjes : Online aplikacioni SKYPE

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Radhe

**Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës:** Zëvendëskryetari z.Gentian Kallmi dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

**Alneida Rroshi:** Të nderuar Këshilltarë ! I nderuar Zëvendëskryetar !

Uroj që të jeni të gjithë mirë familjarisht.

Në mbështetje të nenit 58 “Kryesimi i Mbledhjeve” të Rregullores Funkcionimit të Këshillit Bashkiak :.. “Kryetari kryeson gjithmonë Mbledhjet e Këshillit. Zëvendëskryetari i Këshillit vepron si Kryetar gjatë sëmundjes, apo mungesës së përkohshme të Kryetarit. Në rastin kur Zëvendëskryetari, gjatë kohës që vepron si Kryesues, është i sëmurë apo mungon përkohësisht, Kryetari i Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Ligjore, kur është i disponueshëm, vepron si Kryesues i Mbledhjes...”.

Përsa më lartë kjo mbledhje plenare do të drejtohet nga Unë si Kryetares e Komisionit Rregullores, Çështjeve Ligjore në cilësinë e Kryetares së Komisionit.

Deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë radhe për Këshillin Bashkiak me mjete të komunikimit elektronik . Kjo mbledhje, është kërkuar, nga Kryetarja e Bashkisë. Materialet ju janë vënë në dispozicion nga Sekretarja e Këshillit. Ftoj Sekretaren e Këshillit të bëj prezencën online.

**Dorina Milja:** Përshëndetje të gjithëve! Fillojmë me prezencën.

Jolanda Mustafaraj ... prezent...ok.....deri tek.... Morena Boja....Email.....

Atëherë Alneida ke 25 këshilltarë që u dëgjuan online ke dhe 12 vota me email.

(p.s. Hyri me vonesë dhe votoi Silvana Kavaja, Klementina Meçi dhe Indrit Cërloj, pra 28 këshilltarë online dhe 12 vota me email. Gjithsej 40 vota në mbledhje).

**Alneida Rroshi:** Meqë kuorumi është i pranishëm kalojmë në rendin e ditës dhe miratimin e tij.

Siç jemi njoftuar të gjithë me email sot kemi vetëm 1 pikë në rendin e ditës, e cila është :

1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR RIALOKIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA NGA FONDI I RINDËRTIMIT I BUXHETIT TË SHTETIT, TË PASHPENZUARA NË VITIN 2021, QË DO TË TRASHËGOHEN NË VITIN 2022
---	---

Kemi ndonjë koment?....

A jeni dakort me rendin e ditës ? Nëse po votoni në chat, ju lutem ....

(ndërkohë qetësi, po votohet në chat)...Kundra? .....Apstenim?.....

**Eneida Marku (asistenca teknike):** Dori, nje moment të lutem vetëm një ndërhyrje sapo hyri Silvana Kavaja .

**Dorina Milja:** 26

**Alneida Rroshi:** Më duket se është dhe Klea se ka komentuar pro rendi ditës.

**Eneida Marku (asistenca teknike):** Ja ta verifikoj. Po dhe Klea.

**Dorina Milja:** 27

**Alneida Rroshi :** Eni më ndihmon dot nëse kanë mbaruar me votimin.

**Eneida Marku (asistenca teknike):** Jo, kolegët janë ende duke votuar .

Deri më tani kemi të gjithë kolegët, që kanë votuar pro rendit të ditës, por nuk ka përfunduar.

Ok tashmë përfundoi.

**Alneida Rroshi:** Me të gjitha votat pro miratohet rendi i ditës.

- I jepet fjala për **projektvendimin e pikës 1** Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike z. Elio Jani.

**Elio Jani :** Faleminderit znj.Rroshi ! Përshëndetje të gjithëve !

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike mori në shqyrtim pikën 1 të rendit të ditës për mbledhjen e sotme dhe në mënyrë unanime propozon miratimin e saj. Faleminderit.

**Alneida Rroshi:** Faleminderit Elio.

I jepet fjala për projektvendimin e pikës 1, Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave z.Valentino Mustaka.

**Valentino Mustaka :** Edhe Komisioni i Buxhetit i mbledhur ra dakort në mënyrë unanime që të miratohet pika 1 e rendit të ditës.

**Alneida Rroshi:** Faleminderit Valentino!

Nëse ka pyetje dhe komente?

Para se të kalohet në votim ka deklarata të konfliktit të interesit ?

Nëse jo, kalojmë në votim. Kush është pro, kundër apo apstenim?

.....(ndërkohë qetësi... votohet në chat) .

**Eneida Marku (asistenca teknike) :** Alneida , të lutem dhe Indrit Cërloj hyri dhe votoi pro rendit të ditës.

**Alneida Rroshi:** Faleminderit Eni,

**Dorina Milja:** 28

.....(ndërkohë qetësi... votohet në chat) .

**Alneida Rroshi:** Eni ka përfunduar votimi?

**Eneida Marku (asistenca teknike) :** Ende nuk ka përfunduar, kolegët janë duke votuar. Votimi përfundoi . Atëherë kolegët kanë votuar pro pikës 1.

**Alneida Rroshi:** Faleminderit Eni.

Miratohet pika 1 e rendit të ditës me të gjitha votat pro.

Të lutem Eni mund të shikosh dhe njëherë nëse ka hyrë znj.Velçani, pasi ka kërkuar fjalën.

**Eneida Marku (asistenca teknike) :** Ja ta kontrolloj. Jo nuk e kemi online znj.Etleva.

**Alneida Rroshi:** Nëse Etleva mund të na bashkohet pak më vonë mund t'ja japim fjalën.

Nëse për momentin ka diçka për të thënë zëvendëskryetari z.Kallmi.

**Gentian Kallmi :** Jo, jo. Ju falenderoj.

**Alneida Rroshi:** Faleminderit.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Faleminderit gjithë këshilltarëve.

*Ky procesvebal mbyllet me nr.rendor 4(katër) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset sipas Rregullores së Funksionimit të KB nga Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit.*

**Mbajtësi i proçesverbalit:** Dorina Milja

**Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :**

Kryesuese e mbledhjes së Këshillit Bashkiak : ALNEIDA RROSHI

Sekretare e Këshillit Bashkiak : DORINA MILJA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB : ELIO JANI

Kryetar i Grupit të Pavarur të KB : përfaqesuar nga FLUTURA KASA